



# ROMA INTEGRATION

## HARTA E RRUGËS 2019-2021

### KOSOVË\*





*Roma Integration 2020 is co-funded by*



**OPEN SOCIETY  
FOUNDATIONS**

# Punësimi



Shkalla e punësimit të romët në Kosovë\* nuk gjendet në [Strategjinë Kombëtare për Integrimin e Romëve](#) (SKIR), por indikacionet mund të gjenden në informacionin se shkalla e punësimit për romët është 7%, krahasuar me 40% shqiptarë dhe 21% serb, në dy komuna në Kosovë\*. Të dhënat nga hulumtimi Rajonal për Romët bërë në vitin 2017 përshkruajnë një situatë të ngjashme me vetëm 13% të punësimit në Romë, 21% në popullsinë jorome që jeton afër romëve, dhe një normë mesatare prej 29% për tërë Kosovën\*. Njëkohësisht, Puna e padlekaruar te popullsia rome por edhe jorome në Kosovë\*, është shumë e lartë. Puna e padlekaruar te romët është pothuajse 70%, derisa kjo shkallë te popullsia jorome është 50%. Në një situatë të tillë, vendosja e synimeve për Kosovën\* në drejtim të rritjes së niveleve të punësimit me uljen e njëkohësisht të punës së padeklaruar është një detyrë e vështirë, pasi objektivat duhet të jenë ambiciozë, por gjithashtu të marrin parasysh një kontekst të mbushur me sfida. Nga ana tjetër, duke pasur parasysh që Kosova\* duhet të zgjidhë çështjet e papunësisë dhe punës së padeklaruar në rrugën e saj drejt integritimit në BE, ne gjithashtu mund ta shohim këtë situatë si avantazh. Çështjet e romëve mund të konsiderohen në të njëjtën kohë kur formulohet edhe politika për të gjithë popullsinë, në mënyrë që romët të mos lihen si në disa ekonomi të tjera, por të përdorin, së bashku me të tjerët, përpjekjen e investuar në këto fusha.\* Prandaj objektivat që mund të caktohen për Kosovën\* rritja e shkallës së punësimit dhe rritja me 4% në krahasim me shifrat fillestare deri në vitin 2021, 2025 (me një normë prej të paktën 4%) derisa Kosova\* të ketë një perspektivë të qartë për pranimin në BE. Synimi i një niveli të punësimit 17% deri në vitin 2021 është gjithashtu në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Kosovës\* për Integrimin e Romëve. Këto synime mund të jenë më ambicioze kur Kosova\* të hartojë një politikë efektive për popullatën e përgjithshme. Objektivat për zvogëlimin e punës së padeklaruar mund të përcaktohen në 57% për 2021, 44% për 2025 dhe maksimum 30% deri në kohën e pranimit të Kosovës\* në BE, me vërejtjen e njëkohësisht se këto synime duhet të rishikohen dhe të caktohen në mënyrë më ambicioze pasi Kosova\* të formulojë dhe fillojë të zbatojë një politikë efektive të përgjithshme për të luftuar punën e padeklaruar. Duhet gjithashtu të theksohet se priten ndryshime të normat për popullsinë jorome gjatë përcaktimit të objektivave (megjithëse ato mbeten të njëjta në grafikë si në vitin fillestar). Me gati 70% të romëve të angazhuar në ekonominë informale, mënyra më efektive dhe efektive për të rritur punësimin e romëve do të ishte shndërrimi i ekonomisë informale në formale. Sidoqoftë, Strategjia Kombëtare për Integrimin e Romëve nuk ka parashikuar masa për të shndërruar punën e padeklaruar të romëve në punë të deklaruar. Kjo strategji parashikon mbledhjen e të dhënave për romët e papunësuar, vlerësimin e nevojave të romëve të papunësuar, studimin e modeleve të suksesshme të punësimit nga jashtë, zhvillimin e programeve specifike të punësimit për romët, informimin e romëve për shërbimet publike dhe masat e punësimit, dhe promovimin e modeleve të suksesshme të shembujve rom. Sipas një raporti vjetor të përgatitur nga Qeveria e Kosovës\*, realizimi po devijon nga plani, pasi raportohet vetëm për pjesëmarrjen e romëve në masat e punësimit për të gjithë popullsinë (trajtime në vendin e punës, punë publike, grante të subvencionuara të punësimit për vetëpunësim, puna praktika, arsimi profesional dhe ndërmjetësimi i punës). Gjatë vitit 2017, 1.094 romë morrën pjesë në këto masa, duke përbërë 4% të të gjithë përfituesve. Nga ana tjetër, përfundimet Operacionale të seminareve mbi romët që i kanë të mbajtur Qeveria e Kosovës\* dhe Bashkimi Evropian më 21 shkurt 2018, njohin sfidën e madhe të "ekonomisë së tregut të zi". Rekomandimet për të luftuar këto sfida përfshijnë krijimin e një mekanizmi adekuat për mbledhjen e të dhënave, si dhe identifikimin e fondeve të caktuara nga [Fondi për Inovacion dhe Ndërmarrësi \(FIN\)](#) me qëllim të punësimit të romëve. Megjithëse përfundimet operacionale nuk lidhen drejtpërdrejt me transformimin e punës së padeklaruar, kuota e FIN mund të identifikohet dhe dedikohet këtij qëllimi si metoda më efektive për rritjen e punësimit, me formulimin dhe zbatimin e një programi gjithëpërfshirës të integritimit. Transformimi i ekonomisë informale në formale është parashikuar me [Programin e reformës ekonomike të Kosovës\\* 2019-2021](#), ku vlerësohet se niveli i ekonomisë së zezë është 30% e prodhimit të brendshëm bruto (PBB), dhe është parashikuar që me këtë të merren edhe [Strategjia dhe Plan i Veprimt 2019-2022 për luftën kundër ekonomisë informale](#), që është në hartim e sipër.

\* Ky përcaktim nuk paragjykon qëndrimin ndaj statusit dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.


<sup>1</sup>Në përputhje me përdorimin e tij në institucionet dhe dokumentet e BE-së, termi "Romët" përdoret në këtë dokument si një ombrellë, ku përfshihen grupe njerëzish me prejardhje kulturore pak a shumë të ngjashme, si romë, egjiptianë, ashkali etj. Qofshin në mënyrë jetese nomade apo jo.

<sup>2</sup>Komisioni Evropian, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Banka Botërore për studimin rajonal të Romëve 2017.

<sup>3</sup>Njësoj.

Duhet të theksohet se shoqëria civile u këshillua gjatë hartimit të këtij dokumenti. Shqetësimet kryesore të shoqërisë civile janë se ekonomia informale është aq e përhapur sa praktikisht është e pamundur ta luftosh atë lidhur me romët, se ka mosbesim të institucionet dhe shërbimet publike, dhe se vlera e vlerësuar që rrjedh nga pagesa e taksave është e ulët dhe demotivuese, që të ardhurat totale (nga përfitimet sociale dhe paratë e fituara joformalisht) të mjaftueshme për një jetë të mirë, e cila nuk do të ishte e mundur nëse do hiqej ndihma sociale dhe pagimi i taksave, dhe se sistemi i mbrojtjes sociale është gjithashtu demotivues dhe pasiv. Nuk ka mjete nga fondet IPA që synojnë posaçërisht romët në Kosovë\*. Sidoqoftë, ka programe për popullatën e përgjithshme të financuar nga fondet IPA që janë të rëndësishme për fushën e punës së padeklaruar, si p.sh. „[Realizimi i masave aktive në tregun e punës dhe mbështetja e luftës kundër punës së padeklaruar](#)”, të cilat mund të përdoren për të mirën e romëve. Ekipi i Veprimit për Integrimin e romëve do të punojë me Qeverinë kosovare për të marrë parasysh situatën specifike dhe çështjet që prekin romët në ekonominë informale në kuadër të Strategjisë për luftën kundër Ekonomisë Informale në zhvillim. Ndhma teknike dhe profesionale do të përdoret për të siguruar kontribute të bazuara në fakte për zhvillimin e Strategjisë së përgjithshme dhe për të formuluar masa të përshtatshme brenda Strategjisë që do të arrijnë deri te romët dhe përfitonin prej tyre, me qëllimin përfundimtar të transformimit të punës së padeklaruar në të deklaruar. Ndhma do të marrë në konsideratë sistemin aktual të ndihmës sociale dhe do të propozojë masa që do të lehtësojnë kalimin nga puna e padeklaruar e kombinuar me ndihmën sociale në punën e deklaruar pa ndihmë sociale. Masat e propozuara do të lidhen me masat aktive të punësimit për të përdorur më mirë masat ekzistuese për të transformuar punën e padeklaruar, dhe do të shihen edhe mundësitë e zhvillimit të një programi të krijuar posaçërisht për këtë qëllim, i cili do të financohej rregullisht nga Fondi për Inovacion dhe Ndërmarrësi. Nëse është e mundur, masat e propozuara gjithashtu do të lidhen me mjetet në dispozicion të fondeve IPA (qëllimi i përgjithshëm ose special).

## Strehimi



Fatkeqësisht, nuk ka informacione në dispozicion për situatën e strehimit të romëve në Kosovë\*, në lidhje me pronësinë e njërive të strehimit, pastrehësinë dhe aspektet e tjera në lidhje me pronësinë e siguruar ose qiradhënien. SKIR ofron një përmbledhje të përpjekjeve që ka bërë Kosova\* në vitet 2005-2015, falë të cilave janë siguruar afro 600 njësi strehimi për romët në total, një numër i vogël i shtëpive rome u rindërtuan (kryesisht përmes programeve të kthimit të refugjatëve). Në fushën e strehimit, ekziston një tregues për matjen e suksesit të zbatimit të Strategjisë: "Numri i familjeve që kanë rregulluar statusin e pronës në të cilën jetojnë". Pika e fillimit është 1.200, me një shënim që shpjegon se vlerësohet se 20% e 6.000 familjeve rome në Kosovë\* kanë status të rregulluar ligjor të pasurisë së njësisë së tyre të

strehimit. Burimi i këtij informacioni nuk është në SKIR. Tjetra, SKIR vendos një objektiv prej 3.600 në lidhje me këtë tregues për vitin 2021. Është e paqartë nëse kjo do të thotë gjithsej 3.600 familje ose edhe 3.600 familje të tjera me status të rregulluar për objektin e tyre të strehimit deri në vitin 2021. Bazuar në shifrat e siguruar nga SKIR, supozimi është se ekzistojnë 6.000 familje rome në Kosovë\*, 80% e të cilave nuk posedojnë objektet ku jetojnë dhe janë të kërcënuar me dëbim. SKIR e Kosovës\* përcakton një objektiv të 60% të banesave ilegale në vitin 2021 - një ulje prej 20% (duke legalizuar 1.200 njësi strehimi), e cila përsëritet edhe për 2025 ashtu edhe për vitin në të cilin mund të pranohet Kosova\* në BE. SKIR parashikon zbatimin e programeve për veprimin me objektet ilegale dhe disponueshmërinë e banesave sociale (ndërtimin ose identifikimin dhe adaptimin e objekteve ekzistuese) në nivelin lokal, duke përfshirë zbatimin e [Ligjit për financimin e programeve specifike të strehimit](#). Sidoqoftë, e vetmja veprimtari në fushën e strehimit e raportuar nga Qeveria e Kosovës\* për vitin 2017 ishte ndihma në rindërtimin e shtëpive për 84 familje, akomodimi për 331 familje edhe për 12 muaj, dhe mobiljet për 33 familje, si pjesë e programit të kthimit të refugjatëve. Në Raport gjithashtu thuhet se janë regjistruar nevoja për strehim të 771 familjeve. Programi i Reformës Ekonomike të Kosovës\* për 2019-2021 identifikon nevojën për të siguruar të drejtat e pronës me zgjidhjen e çështjeve të pronave të paluajtshme informale, të cilat janë të përfshira nga [Strategjia Kombëtare për të drejtat pronësore](#) dhe e regullon para së gjithash [Ligjin për trajtimin e ndërtesave pa leje](#). Sipas Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Kosovës\*, [Ligji për Strehimin Social](#) është aktualisht në zhvillim e sipër dhe ka nevojë për ndihmë teknike dhe profesionale në këtë proces. Meqenëse legjislacioni për strehim nuk rregullon procedurën në rastin e zhvendosjes së familjeve nga banesat e që nuk mund të legalizohen, Ligji i ri duhet të lidhet me rregulloret e strehimit për të filluar procedurën e nevojshme për të siguruar strehimin e familjeve të shpërngulura. Me kërkesë të Qeverisë së Kosovës\*, Ekipi i Veprimit për Integrimin e Romëve do të sigurojë asistencë teknike në përgatitjen e Ligjit për strehimin social, lidhjen e tij me Ligjin për trajtimin e objekteve pa leje dhe hartimin e një propozimi me financim të plotë që do të siguronte ndihmë për romët dhe qasje në legjislacionin e strehimit, dhe strehimi social do sigurohej për familjet, strehimi i të cilave nuk mund të legalizohet.

\*Hulumtimi rajonal nga viti 2017 jep informacion për lidhjet me shërbimet komunale, qasje në tualete, dru zjarri, mbajtjen e celularit / kompjuterit dhe mbipopullimin. SKIR nuk përmban informacione për situatën në vitin e fillimit.

